



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2019:153803

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05559409

**C. nr. 198/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, përmes gjyqtarit Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.D. nga .....”, pa nr, të cilën me autorizim e përfaqëson Zijadin Spahiu, avokat nga Kamenica, kundër të paditurve I. P. nga .....”, pa nr, të cilin me autorizim e përfaqëson Refik Basha, avokat nga Kamenica dhe Zh. P. nga .....”, pa nr, tani me me objekt kontesti për kthim në shtëpi dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët gjatë martesës, me vlerë të kontestit prej 5,000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datën 01.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSIDEROHET si e tërhequr** padia e paditëses S D nga me numër C. nr. 198/2018, e datës 05.12.2018, e parashtruar kundër të paditurve I. P. nga ....., dhe Zh. P. nga ....., ..... pa nr, tani me adresë të panjohur, për kthim në shtëpi dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët gjatë martesës, me vlerë të kontestit prej 5,000.00 euro.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësja S. D. nga .... ”, pa nr, të cilën me autorizim e përfaqëson Zijadin Spahiu, avokat nga Kamenica, më datën 05.12.2018, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurve I. P. nga .....”, pa nr, të cilin me autorizim e përfaqëson Refik Basha, avokat nga Kamenica dhe Zh. P. nga .....”, pa nr, tani me adresë të panjohur, me objekt kontesti për kthim në shtëpi dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët gjatë martesës, me vlerë të kontestit prej 5,000.00 euro.

Gjykata, duke e pasur parasysh që të paditurit Zh. P. nga ....., nuk ka qenë e mundur t’i gjindet adresa e saktë e vendbanimit apo vendqëndrimit, edhe pas kërkesave prej institucioneve relevante, me propozimin e të autorizuarit të palës paditëse, me aktvendim C. nr. 198/2018, të datës 09.02.2024, e ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm, për të vepruar në emër të të paditurit Zh. P. nga .....”, pa nr, tani me adresë të panjohur.

Po ashtu, gjykata përmes Aktvendimit C. nr. 198/2018, të datës 09.02.2024, e ka urdhëruar paditësen S. D. nga .....,” pa nr, përmes të autorizuarit të saj, avokatit Zijadin Spahiu, që në afat prej dhjetë (10) ditësh, pas ditës së pranimit të aktvendimin të lartëcekur, t’a bëjë deponimin në xhirollogarinë – arkën e kësaj gjykate, të shumës prej 613.00 euro, në emër të paradhënies për shpërblimin e punës të përfaqësuesit të përkohshëm. Përveq kësaj gjykata përmes aktvendimit të lartëcekur, e ka njoftuar paditësen dhe të autorizuarin e saj, që nëse nuk e kryen detyrimin e përcaktuar për pagesën e shumës së lartëcekur në emër të paradhënies për shpërblimin e punës së përfaqësuesit të përkohshëm, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga propozimi për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, e rrjedhimisht do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Gjykata, duke e pasur parasysh faktin se paditësi, respektivisht i autorizuari i tij avokati Zijadin Spahiu, përmes aktvendimin të lartëcekur, më datën 20.02.2024, ka qenë i njoftuar dhe i detyruar, për t’a deponuar në xhirollogarinë - arkën e kësaj gjykate, shumën e lartëcekur në emër të shpërblimit të punës të përfaqësuesit të përkohshëm, dhe i njëjti deri në datën e sotme kur edhe është nxjerrur ky aktvendim, nuk e ka paguar shumën e lartëcekur dhe gjykatës nuk i ka ofruar prova për deponimin e kësaj shumë në xhirollogarinë - arkën e kësaj gjykate, respektivisht në rastin konkret kanë kaluar 1 muaj e gjysëm, nga dita kur paditësi e ka pranuar obligimin e lartëcekur përmes së cilit e ka pasur për detyrim që t’a deponoj shumën prej 613.00 euro, si paradhënie në emër të shpërblimit të punës së përfaqësuesit të përkohshëm, ndërsa në anën tjetër i njëjti këtë detyrim është dashur që t’a përmbush brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh, pas ditës së pranimit të detyrimit të lartëcekur.

Duke i pasur parasysh të lartëcekurat e duke u bazuar në dispoziten e nenit 81 paragrafi 2 të LPK-së, ku përcaktohet se *“Në rastet nga paragrafi 2, i nenit 79 të këtij Ligji, i padituri ka përdetyrë të deponoj shumën e të hollave, për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, kurse në rastet nga paragrafi 3 i të njëjtit nen, shpenzimet i deponon paditësi”*, e lidhur me dispoziten e nenit 387 paragrafi 1, pika q), të LPK-së, gjykata erdhi në përfundim se paditësi nuk e ka përmbushur detyrimin e tij brenda afatit të caktuar nga gjykata nga dita kur ka qenë i njoftuar për detyrimin e tij dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartëcekurat, e duke u bazuar në dispoziten e nenit 81 paragrafi 2, 387 paragrafi 1, pika q), e lidhur me nenin 261, të të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**C. nr. 198/2018, i datës 01.04.2024**

**G j y q t a r i**  
**Artan Abazi, d. v**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimi të të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate.